VENDIM
Nr.43, datë 31.8.2005

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS SË PARAQITUR NGA SHOQËRIA "SARMIER" SHPK

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", me ndryshimet përkatëse, neni 11 pika A dhe neni 22, Bordi i Komisionerëve të ERE–s, në mbledhjen e tij të datës 31.8.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria Sarmier sh.p.k. për vendosjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria Sarmier sh.p.k. për vendosjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, pasi kërkesa nuk është bërë në përputhje me nenin 22 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.
2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve të njoftojë shoqërinë Sarmier sh.p.k. dhe ta informojnë atë për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema